



Dr. Erdet Këlliçi

**Zv. Dekan & Përgjegjës i Departamentit të
Inxhinierisë Kompjuterike
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Tirana Business University College**

Dr. Erdet Këlliçi është Përgjegjës i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Tirana Business University. Ai është diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në Universitetin e Tiranës, në vitin 2003. Ai zotëron një diplomë “Master në Administrim Biznesi” nga Universiteti i Tiranës dhe ka gradën “Doktor i Shkencave” në Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit.

Puna e tij kërkimore shkencore fokusohet në analizën e përdorimit të teknologjisë mobile në rritjen e reticencës së sistemeve ERP dhe sjellja e përdoruesve të kësaj teknologjie. Ai ka punuar në kompaninë energjetike CEZ Albania, në pozicionin e Drejtorit të Operacioneve IT dhe ka qenë personi kyç për zbatimin e teknologjisë mobile në leximin e matësave në këtë kompani. Gjithashtu, Dr. Këlliçi ka qenë personi kyç në zbatimin për herë të parë në Shqipëri të sistemit të votimit elektronik në zgjedhjet parlamentare të 24.04.2021. Ai ka përmbushur disa detyra të rëndësishme konsulencë në fushën e energjetikës dhe mësimin online për kompanitë prestigjioze Ecorys dhe Roland Berger. Ai ka publikuar disa studime shkencore në fushën e teknologjisë mobile, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.